



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-1815/24 datë:20.01.2025



Npi – 01/27 datë: 27.01.2025

Duke u bazuar në Nenin 12.2 pika (d), Nenin 17 pika (k), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 5.4.4, dhe nenin 8.1 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255; Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe financa Npi-01/13 dt. 24.01.2025; Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/17 dt. 24.01.2025; Propozim-Vendimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Nr.07/04 dt.20.01.2025; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 27.01.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN NGA 150 € NË MUAJ PËR FAMILJET E KOMUNËS SË SHTIMES QË STREHOJNË FËMIJË PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -I- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 27.01.2025, me shumicën e votave miratoi, Vendimin për ndarjen nga 150 € për ç'do muaj, për secilën familje që ka strehuar fëmijë pa përkujdesje prindërore në Komunën e Shtimes, deri më 31.12.2025.

II

Të drejtën mbi bazën e këtij vendimi e gëzojnë të gjitha Familjet e Komunës së Shtimes që kanë strehuar një ose më shumë fëmijë pa përkujdesje prindërore, mbi bazën e kërkesës që do ta paraqet familja në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sipas kritereve që duhet plotësuar. Kohëzgjatja e pagesës është 12 muaj duke filluar nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025. Pagesa vjetore për një familje arrinë shumën prej 1800 euro.

III

A r s y e t i m: Vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes për subvencionimin e Familjeve Strehuese, është miratuar nga anëtarët e Kuvendit, sipas propozimit të Propozimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Nr.07/04 dt.20.01.2025. Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe financa Npi-01/13 dt. 24.01.2025. Rekomandimit të Komitetit për Komunitete Npi-01/17 dt. 24.01.2025. Si dhe mbi bazën e zotimeve për ta ndihmuar këtë kategori të familjeve në programin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nga shuma 130,734.00 euro e ndarë për Subvencione dhe Transfere në DSHMS.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi